



**PLANI STRATEGJIK I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
TË SHQIPËRISË:
NJË INSTRUMENT PËR PËRMIRËSIMIN E INSTITUCIONIT
2022 - 2026**



Disa fjalë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Suksesi i një planifikimi strategjik varet nga shumë faktorë, por kryesori është angazhimi solid institucional. Pikëpyetjet janë reagime normale kur fillon puna për një plan strategjik dhe janë krejt të mirëkuptueshme sepse strategjia synon të ndryshojë ose të rregullojë një situatë të caktuar. Por një angazhim i mirëfilltë institucional përbën garanci se plani strategjik do ta transformojë institucionin dhe do ta bëjë atë më të aftë për të shërbyer.

Një strategji e nisur nga poshtë-lart është gjithashtu vendimtare për një plan strategjik të suksesshëm. Teksa ishim të investuar në përpilimin e planit strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jemi përpjekur pareshtur që kjo nismë të mos mbetet si ushtrim teorik, e të mos ishte në gjendje të kishte një ndikim real në veprimtarinë e institucionit. Nëse synimet, veprimet dhe aktivitetet rezultojnë nga propozimet e brendshme dhe përmirësohen më tej, gjasat për një zbatim të suksesshëm dhe për një vijimësi të vërtetë janë shumë më të larta.

Të gjitha hallkat e përfshira në konsolidimin e kësaj strategjie janë treguar krejt realiste. Planet strategjike shpesh hartojnë lista iniciativash jashtëzakonisht interesante që vështirë se mundet të zbatohen, duke pasur parasysh burimet financiare në dispozicion apo edhe faktorë të tjerë.

Ajo çka garantojmë për të ardhmen si Komision Qendror i Zgjedhjeve, është se KQZ do të mbajë pronësinë e plotë të procesit, edhe përtej fazës së hartimit, dhe se do të ekzistojnë mekanizma të brendshëm funksionalë për të udhëhequr fazën e zbatimit, ndjekjen dhe vlerësimin përfundimtar.

Kjo strategji për KQZ-në është një mjet kyç që do të përmirësojë rrugën për të arritur qëllimet tona institucionale. Mbi të gjitha strategjia nuk është vetëm një dokument. Në realitet është një listë detyrash, objektivash dhe procesesh, që përtej rezultatit përfundimtar konsiston në një sërë aktivitetesh dhe indikatorësh, krejtësisht të matshëm dhe realë.

Mbarësi,

Ilirjan Celibashi
Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



Përmbajtje

- 1. Hyrje në Planin Strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Shqipëri**
- 2. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore**
- 3. Plani Strategjik për drejtoritë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**



1. Hyrje në Planin Strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë

Pas zgjedhjeve parlamentare të prillit 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me mbështetjen e Këshillit të Evropës, nisi përgatitjen e një plani strategjik për përmirësimin e funksionimit të KQZ-së, me qëllim realizimin e zgjedhjeve më të mira.

Plani strategjik synon të orientojë përpjekjet e KQZ-së dhe të përmirësojë mënyrën e arritjes së **objektivave të saj strategjike**. Më shumë se dokument, ai është proces, në kuptimin që, përtej rezultatit përfundimtar që përbëhet nga një grup aktivitesh dhe treguesish, plani strategjik përmirëson një proces që e bën institucionin të mendojë për veten.

Plani strategjik u hartua në dy faza dhe në bashkëpunim të ngushtë me personelin e KQZ-së, përfshi të gjitha drejtoritë (Drejtoria Juridike dhe e Dokumentacionit Zgjedhor, Drejtoria e Komunikimit, Zëdhënësi, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve Informatike, Drejtoria e Kontrollit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës, Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore).

Së pari, u organizua një takim fillestar që mbledhi bashkë drejtoritë e KQZ-së dhe konsulentin e jashtëm. Takimi pati si synim të informonte gjithkënd se çfarë është plani strategjik, çfarë pritshmëri duhen parashikuar në mënyrë të arsyeshme dhe, në fund, të arrinte t'i bënte të gjitha palët e interesuara të angazhoheshin e të ishin në një linjë.

Së dyti, të gjitha drejtorive iu shpërndanë dy formate tip: një analizë e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT), që ofron orientime të dobishme për fushat ku duhet punuar, nismat për rritjen e aftësive dhe mënyrat e trajtimit të kërcënimeve, si dhe një tabelë ku duheshin përshkruar aktivitetet e planit strategjik. Tabela ishte e ndarë në parametra të ndryshëm: objektivat, masat, aktivitetet dhe treguesit. Edhe pse masat pasqyrojnë fusha të gjera që mbulohen nga një drejtori e caktuar, çdo masë zërthehet në aktivitete konkrete dhe çdo aktivitet lidhet me treguesit specifikë, të cilët janë komponentë kyç të planit strategjik. Më pas, u zhvilluan takime me të gjitha drejtoritë, për të plotësuar analizën SWOT dhe tabelën.

2. Procesi i planifikimit strategjik: gjetjet dhe rekomandimet kryesore

Aktualisht, KQZ-ja ka një personel shumë të përkushtuar, të aftë për të kryer detyra të vështira në kushte stresuese. Si planifikimi strategjik, që është një aktivitet i cili kërkon një lloj thellimi nga secila drejtori, ashtu edhe aftësia për të krijuar hapësira të reja novatore dhe dialogu me personat përgjegjës përkatës tregoi se ekziston një bazë e fortë për zbatimin e mëtejshëm të aktiviteteve të planit strategjik, për të cilat kërkohen gjithnjë standarde të larta profesionale.

Megjithatë, ka një deficit strukturor që shkon përtej përpjekjeve të caktuara institucionale dhe gatishmërisë për t'u përmirësuar që vjen nga individët dhe njësitë, që, përgjithësisht, nuk janë në gjendje t'i tejkalojnë të tilla pengesa me natyrë më të përgjithshme. Disa nga faktorët kryesorë bazë (p.sh., mungesa e burimeve, vonesa në dhënie të fondeve të buxhetit, ndryshimet ligjore të minutës së fundit, ndryshimi i drejtuesve, menaxhimi i dobët strategjik) e pengojnë KQZ-në t'i realizojë zgjedhjet në mënyrë më efikase. Duke pasur parasysh këtë, plani strategjik nuk zbulon probleme që nuk priten. Ai përforcon nevojën për zbatimin e aktiviteteve afatmesme dhe afatgjata, që mund të përmbysin situatën aktuale.

Edhe pse KQZ-ja është një ent i vetëm publik që ka zgjedhjet si produkt të përgjithshëm, njësitë e saj merren me shumë çështje të tjera dhe, për rrjedhojë, kanë nevoja të ndryshme. Edhe pse ka disa shqetësime të përbashkëta, plani strategjik kombinon qasjet e përgjithshme dhe specifike për drejtori të ndryshme.



Plani strategjik propozon marrjen e masave konkrete gjatë viteve të ardhshme dhe këto nisma u përshtaten nevojave të institucionit në përgjithësi dhe të njëjësive përkatëse.

Këtu kombinohen dy qasje:

- Gjetjet dhe rekomandimet që mund të përdoren për të ushtruar ndikim tek aktorët e jashtëm, që ata t'i kuptojnë më mirë nevojat e KQZ-së. Kjo ka të bëjë me pengesat ligjore, politike, administrative dhe, sigurisht, ekonomike që KQZ-ja duhet të tejkalojë.
- Gjetjet dhe rekomandimet duhen përdorur për të përmirësuar aktivitetet e KQZ-së me mjete e veta të brendshme. Në të kundërt, mund të ketë një lloj efekti apatie. Asnjë novacion nuk mund të nisë thjesht duke ndenjur në pritje të një konteksti optimal institucional që nuk do të vijë kurrë. Në këtë drejtim, plani strategjik përfshin aktivitete që mbështeten te ndryshimet ligjore ose përkrahja politike, por parashikon kryesisht masa që mund (dhe duhen) marrë nga vetë KQZ-ja për të konsoliduar një nivel të lartë pune dhe efikasiteti.

Në përputhje me sa u tha më sipër, një mekanizëm formal **vlerësimi** dhe që në nivel sistemi do të lejonte një identifikim më të mirë të hendeqeve kryesore dhe fushave për përmirësim. Aktualisht, KQZ-ja po zbaton disa nisma në këtë drejtim, si mbledhjet e analizës vjetore, ku të gjitha drejtoritë vlerësojnë atë çfarë është bërë dhe diskutojnë atë çfarë mund të bëhet për t'u përmirësuar më tej. Megjithatë, procesi mund të zyrtarizohet më tej sa u takon treguesve që duhen vendosur, vlerësimeve që duhen kryer dhe masave për përmirësim që duhen marrë.

Ndryshimi i kulturës institucionale është ai që kërkon kohë, por vlen të theksohet se këto vlerësime dhe kjo atmosferë e re cilësore është po aq e rëndësishme sa lista e aktiviteteve që duhen zhvilluar. Masat, edhe ato që janë të mira, pa vlerësime konkrete dhe të rëndësishme nuk do ta forconin institucionin.

Ka po ashtu një prirje, sipas të cilës, vlerësimet mbështeten kryesisht te treguesit sasiorë (p.sh., numri i mbledhjeve) dhe jo te faktorët cilësorë (d.m.th., përmirësimet thelbësore). Plani strategjik i kundërvihet kësaj qasjeje të thjeshtuar dhe, së bashku me disa shifra, synon të propozojë tregues që mund të vlerësojnë nëse objektivat kryesore të KQZ-së janë arritur ose jo si duhet.

Bashkë me vlerësimin e arsyeshëm të burimeve njerëzore dhe ekonomike, duhet edhe **vendosja e përparësive**.

Përditësimet e sistemit informatik do t'i sjellin përfitime të gjithë institucionit. Së pari, disa aplikacione të reja elektronike, si identifikimi elektronik me nënshkrim biometrik i votuesve ose sistemi i votimit elektronik, janë bërë të detyrueshme, si pasojë e kodit të ri zgjedhor. Ato janë risi shumë kërkuese sa i përket aspektit informatik, por, gjithashtu, kanë nevojë për përshtatje të konsiderueshme nga pikëpamje të tjera, si edukimi i votuesit apo bashkëpunimi midis aktorëve. Për më tepër, këto risi i kërkojnë një institucioni, ku tashmë janë shënuar mangësi të tjera në sistemin informatik. Këto detyrime të reja janë, për pasojë, ngarkesa teknologjike që e bëjnë më sfidues një skenar, që kishte tanimë nevojë për përmirësime të konsiderueshme informatike.

Së dyti, edhe për funksionet e përditshme të KQZ-së duhet një përditësim i gjithanshëm i sistemit informatik. Normat e efikasitetit të një sërë aktiviteteve të KQZ-së janë të ulëta, kryesisht për shkak të një procesi pune që vazhdon të mbështetet shumë te procedurat në letër dhe shpërfill avantazhet që ofrojnë aplikacionet informatike. Në terma të përgjithshme, KQZ-ja do të përfitonte nga një strukturë e brendshme gjithëpërfshirëse e teknologjisë së informacionit, që do të përshpejtonte proceset, do të ulte mbivendosjet dhe do të rriste bashkëpunimin midis drejtorive. KQZ-ja ka nevojë për një sistem modern të menaxhimit të aseteve. Sërish, kjo nuk është detyrë e lehtë, pasi përfshin menaxhimin e një ndryshimi të gjerë institucional, që nis nga studimet paraprake të fizibilitetit, deri te zbatimi faktik i



produkteve të ndryshme. Zotërimi institucional, familjarizimi i përdoruesve, afatet e arsyeshme ose procesi i ndryshimeve gjithëpërfshirëse janë parametra të rëndësishëm dhe, shpesh, shkak për dështime. Së fundi në radhë, por jo për nga rëndësia, një sistem i tillë i përgjithshëm informatik i menaxhimit duhet t'iu kushtojë vëmendje të posaçme moduleve të veçanta, sipas drejtorive (p.sh., rekrutimi, buxheti, edukimi i votuesve), që do të thotë se sistemi duhet të ofrojë një qasje të përgjithshme bashkë me module të veçanta dhe, së bashku, duhet të funksionojnë në mënyrë miqësore për përdoruesit dhe të jenë të fortë teknikisht.

Në përfundim, KQZ-ja ka nevojë për një strategji të përgjithshme informatike, që duhet zbatuar brenda një afati të arsyeshëm, domethënë, brenda një periudhe afatshkurtër dhe afatmesme. Në tabelat e mëposhtme vërehet përmendja disa herë e novacioneve informatike, jo vetëm te tabela që i kushtohet Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, çka tregon fushëveprimin dhe rëndësinë faktike që kanë këto instrumente.

Gjatë viteve të fundit, KQZ-ja u ka kushtuar vëmendje disa herë çështjeve të trajnimit dhe, në një pikë të caktuar, parashikoi një qendër për formimin e vazhduar, e cila nuk u realizua. Ka hapësirë për përmirësime në këtë drejtim. Kjo do të përfshinte personelin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, edhe pse nevojat dhe metodika e përdorur në secilin rast do të ndryshonte.

Së pari, personeli i KQZ-së ka nevojë për një strategji të përhershme trajnimi, që synon të rritë kapacitetet e brendshme në mënyrë të qëndrueshme dhe efikase. Përveç kurseve të caktuara, një qasje afatmesme dhe afatgjatë do të merrte parasysh nevojat specifike të KQZ-së dhe do të ndërtonte një program trajnimi të gjithanshëm. Po kështu, është me rëndësi që KQZ-ja të rritë zotërimin dhe njohuritë e saj, në mënyrë që vetë institucioni të jetë në gjendje të hartojë, të realizojë dhe të vlerësojë një program të tërë. Edhe pse KQZ-ja mund të përfitojë nga bashkëpunimi dhe partneriteti me aktorë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ajo duhet të ruajë drejtimin tërësor të aktiviteteve të trajnimit. Për më tepër, lista e seminareve duhet të pasqyrojë nevojat e përgjithshme dhe të veçanta. Edhe pse ka disa aftësi nga të cilat mund të përfitojë i gjithë personeli i KQZ-së, aktivitetet e trajnimit duhen organizuar në bashkëpunim të ngushtë me njësitë përkatëse dhe temat duhen përshtatur sipas këtyre profileve.

Së dyti, në rastin e personelit me kohë të pjesshme, rekomandohet ndjekja e një qasjeje krejt ndryshe. Këta persona i shërbejnë KQZ-së për një periudhë të shkurtër dhe kanë nevoja shumë specifike sa i takon trajnimit. Për rrjedhojë, duhet hartuar paraprakisht një strategji e fortë dhe e qëndrueshme. Aktivitetet përgatitore për trajnime që lidhen me zgjedhje të caktuara duhet të nisin shumë më përpara, me trajnimin e trajnerëve, vlerësimet metodologjike dhe nisma të ngjashme. Kur shpallen zgjedhjet, duhen ndezur menjëherë motorët dhe të gjithë aktorët duhet ta dinë se cili është saktësisht roli i tyre. Për më tepër, do të ishte me shumë dobi të disponohej një listë aktive. Bashkë me aktivitetet për zbulimin e talenteve, KQZ-ja mund të mbajë lidhje të vazhdueshme me njerëzit që do të thirren për periudhën e zgjedhjeve. Lidhur me këtë, një sërë nismash mund të tërheqin rregullisht vëmendjen e grupeve të ndryshme dhe mund të krijohet një komunitet joformal i KQZ-së, që do të ishte burim i shkëlqyer kandidatësh, sa herë të dilte nevoja.

Puna e KQZ-së kushtëzohet seriozisht nga vendimet e papritura politike dhe ligjore dhe, për t'u përballur me këtë faktor, duhet ndërtuar rezistenca institucionale. Nga njëra anë, KQZ-ja nuk ka kontroll mbi vendimet që merren nga institucionet e tjera dhe që kanë ndikim mbi veprimtarinë e saj të përditshme. Çdo plan strategjik, edhe ai më elastiku që do të merrte në konsideratë skenarë të ndryshëm, do të kishte probleme, nëse thirren zgjedhje të parakohshme apo miratohen ligje të minutës së fundit, pa pasur kohë për zbatimin e duhur të tyre. Nga ana tjetër, KQZ-ja duhet të gjejë një mënyrë për t'i përpunuar këta faktorë sfidues, duke konsoliduar një institucion të aftë për të minimizuar pasojat e tyre negative, duke iu përmbajtur qartë angazhimit në kuadrin e saj strategjik. E thënë shkurt, KQZ-ja duhet të ketë besim te kapacitetet e veta dhe të mos t'u vërë veshin ndërhyrjeve të jashtme.



Plani strategjik ngrihet mbi këtë pikënisje. Ai identifikon faktorët që ndërhyjnë tek aktivitetet e KQZ-së, si rregulloret që parashikojnë funksione të reja pa afate ose burimet njerëzore/ekonomike shtesë. Plani strategjik ka për qëllim t'i parashikojë këta faktorë, duke nxitur përfshirjen aktive të KQZ-së në ndryshimet ligjore në të ardhmen. Edhe pse KQZ-ja nuk duhet të zëvendësojë Parlamentin, ajo mund të kryejë një analizë dhe të propozojë ndryshime që do të synonin përshtatjen e procedurave të reja ligjore në strukturën institucionale të KQZ-së.

Së dyti, plani strategjik nuk i pranon të tillë faktorë të jashtëm si pretekste për të justifikuar mosveprimin ose punën e dobët të KQZ-së. Ka një mori nismash që duhen ndërmarrë, pavarësisht kuadrin ligjor në fuqi dhe kohës se kur miratohet ai. Masat makro dhe mikromenaxhuese, si ato që propozohen nga plani strategjik, do të sillnin si rezultat një KQZ më rezistente, që do të ishte e varur më pak nga ndryshimet e jashtme.

KQZ-ja duhet të eksplorojë fushat që ligji i ka lënë të hapura dhe të mos presë që Parlamenti të hartojë legjislacion të ri. Rregulloret e KQZ-së duhet të ofrojnë një arkitekturë për aktivitetet e reja dhe vetëm t'u hapin rrugë masave të zbatimit të miratuara nga aktorët e jashtëm. Pavarësisht kufizimeve të qarta që paraqet kuadri ligjor, hapësira që ka KQZ-ja për të manovruar është shumë më e madhe se çfarë perceptohet realisht. Aktualisht, ekziston një lloj vetëpërmbytjeje, për shkak të supozimit se për thuajse çdo gjë është i nevojshëm ligji. Autorësia institucionale e KQZ-së minohet nga kjo qasje e gabuar ligjore. Edhe pse natyrisht gjen zbatim ligji, ky parim pranon dhe, madje, nxit administrata aktive, që janë të afta të trajtojnë problemet e brendshme sociale, në përputhje me kuadrin ligjor, por jo tërësisht të varura prej tij. Kjo qasje duket qartë kur KQZ-ja është e detyruar të reagojë ndaj kërkesave të papritura dhe rregullorja e KQZ-së duket se është i vetmi mjet mundësues, por e njëjta qasje mund të zbatohet edhe më gjerë.

Një shqetësim i zakonshëm që e kanë drejtoritë e ndryshme është mungesa e bashkërendimit të mjaftueshëm të brendshëm midis sektorëve të KQZ-së, që ul efikasitetin dhe krijon ngarkesa procedurale. Edhe pse, sigurisht, përmirësimet informatike të përmendura më lart do t'i trajtojnë këto hendeqe, duhet theksuar se ekzistojnë shkaqe më të thella, çka do të thotë se do të duheshin ndryshime më të gjera për t'i përmbysur praktikatat e këqija. Aspekti i teknologjisë së informacionit i vetëm nuk do të ishte i aftë të zgjidhte të gjitha mangësitë themelore. Kjo është arsyeja pse duhet ndërmarrë një nismë strukturore, që synon racionalizimin e mekanizmave të brendshëm të bashkëpunimit. Duhet procedura standarde veprimi të përmirësuara për çdo sektor dhe aktivitet. Plani strategjik përmend fusha specifike të ndryshme, ku përmirësimi i këtij bashkërendimi do të kishte efekte pozitive, por, në çdo rast, programi duhet të shkojë përtej fushave të veçanta dhe të përfshijë të gjithë institucionin. Kjo është mënyra e vetme për ri-përkufizimin e proceseve të brendshme të punës. Kjo qasje gjithëpërfshirëse përputhet me vëmendjen që u duhet kushtuar disa fushave dhe rasteve studimore, të cilat duhen promovuar dhe paraqitur si praktika të mira.

Plani strategjik u kushton vëmendje edhe mjeteve fizike, që do të thotë, kushteve materiale në të cilat kryen aktivitetet e saj KQZ-ja. Proceset, njohuritë dhe ekipet e punës me njerëzit janë të nevojshme, por kërkojnë një kuadër të fortë, që është i lehtë për t'u përdorur. Në këtë drejtim, dokumentet identifikuan disa mangësi sa i takon blerjes së pajisjeve të nevojshme. Plani strategjik propozon një vështirësi më të gjerë kur merr në konsideratë të tilla përmirësime materiale. Për fat të keq, duke e parë në një qasje krahasuese ndërkombëtare, nuk është e pazakontë që investime të tilla të rezultojnë në para që shkojnë dëm shumë lehtë. Përveç materialeve të blera, institucioni nuk ishte i aftë t'i përdorte, për shkak të hendeqeve procedurale dhe në trajnim. Ja pse çdo blerje e KQZ-së duhet shoqëruar me një plan veprimi, që do të thotë, me një lloj mini-programi strategjik, që ka për qëllim të sigurojë vënien si duhet në punë të mjeteve të reja.

Së fundi, ekziston një shqetësim rreth mënyrës si perceptohet imazhi i institucionit dhe, për rrjedhojë, i kushtohet rëndësi keqinformimit, që mund të dëmtojë pavarësinë dhe besueshmërinë e KQZ-së. Ky



nuk është tipar i veçantë vetëm i KQZ-së shqiptare, pasi epoka digjitale i përmban këto situata sfiduese. Në çdo rast, sidoqoftë, vlen që të mos neglizhohen. Për më tepër, zbatimi i duhur i planit strategjik do të ishte i pamjaftueshëm, duke qenë se fushata të tilla nisin pavarësisht punës aktuale të institucionit. Ja pse duhet një strategji konkrete komunikimi në këtë drejtim.



3. Plani strategjik për drejtoritë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1) DREJTORIA JURIDIKE DHE E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Rritja e besimit të publikut tek integriteti i procesit të regjistrimit të partive politike dhe kandidatëve në zgjedhje
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Rritja e kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimit të mjaftueshëm	Rritja e efektivitetit të zbatimit dhe aftësive reaguese ndaj reformave dhe sfidave të reja zgjedhore	Formim vazhdues për hetimin administrativ	Është në gjendje të përcaktojë kompetencën e Komisionerit në raport me çështjet në shqyrtim Zotëron njohuritë për mjetet e kërkimit të të dhënave Respektton afatet e kryerjes së hetimit administrativ
		Kualifikim në vazhdim për hartimin e ligjeve dhe teknikën legjislative	Komentimi dhe korrigjimi i dispozitave ligjore, duke trajtuar paqartësinë, papërshtatshmërinë dhe kushtet jopraktike për përdoruesit Përmirësimi i njëtrajtshmërisë dhe harmonizimit të akteve nënligjore
Ngritja e mekanizmit për bashkëpunim periodik me OShC-të, partitë politike dhe botën akademike për rishikimin e rregullave ekzistuese dhe rekomandimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore	Rritja e angazhimit me aktorë të rëndësishëm, për të hartuar një kuadër ligjor zgjedhor mbështetur në analizën, rekomandimet dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare përmes një procesi pjesëmarrës	Koordinim i akteve rregullatore ndërmjet Komisionerit, Komisionit Rregullator dhe angazhimi i OShC-së	Rishikim i rregullores së KQZ-së për hartimin e legjislacionit dytësor (p.sh., afatet, lista e aktorëve e hartuar paraprakisht dhe formalizimi i procedurave) Faqja e internetit e KQZ-së do të përmirësojë tiparet e konsultimit publik
		Platforma elektronike për përcjelljen e akteve rregullatore nga Komisioneri te Komisioni Rregullator	Kostoja e studimit të fizibilitetit dhe e hartimit të projektit Zbatimi i platformës për aktet elektronike (<i>E-Act</i>) Trajnime
			Tryeza të rrumbullakëta me aktorët (OSHC-të/partitë politike)
Regjistrim zgjedhor më miqësor dhe i	Lehtësimi i procesit të regjistrimit të subjekteve dhe		



aksesueshëm për përdoruesin	kandidatëve zgjedhorë, përfshi regjistrimin elektronik ose përmirësimin e rritjen e aksesit për regjistrim në zgjedhje	Hartimi i dispozitave ligjore/ nënligjore për zbatimin e dorëzimit elektronik të dokumenteve nga partitë politike	Marrëveshje informale bazuar në Kodin e Etikës lidhur me zbatimin e regjistrimit elektronik të kandidatëve
		Aplikimi dhe zbatimi i regjistrimit elektronik të kandidatëve të partive politike	Miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore që i japin kompetencë KQZ-së për zbatimin e Projektit
			Hartimi i termave të referencës
			Prodhimi i sistemit
			Zbatimi i sistemit të paktën një vit përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.
		Formimi vazhdues i përdoruesve fundorë dhe përmirësimi i sistemit (p.sh., partitë politike, personeli i KQZ-së, vëzhguesit, administrata e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ))	Konsultimi me partitë politike, për të vlerësuar dhe përmirësuar më tej sistemin.
Hartimi dhe rishikimi i materialeve të trajnimit			
Kryerja e trajnimit të trajnerëve			
Zbatimi i vlerësimit përfundimtar dhe vënia në jetë e mësimave të nxjerra			

SHTYLLA STRATEGJIKE II		OBJEKTIVI STRATEGJIK 2	Prezantimi dhe zbatimi i mekanizmave të rinj ligjorë në procesin zgjedhor
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Përmirësimi i ligjit zgjedhor dhe strukturave organizative, për ngritjen e një administrate zgjedhore kompetente, për të zhvilluar zgjedhje të lira e të ndershme	Rritja e efikasitetit dhe paanshmërisë së administratës zgjedhore	Dhënia e sugjerimeve për komisionin e reformës së legjislacionit zgjedhor, të përfutur nga përvojat vendase dhe të huaja	Identifikimi i çështjeve (p.sh., emërimi i personelit të qendrave të votimit, zëvendësimi i kandidatëve) dhe kryerja e studimeve krahasuese
		Hartim i integruar i ligjit lidhur me zgjedhjet dhe menaxhimin e zgjedhjeve	Hartimi i propozimeve për ndryshime ligjore dhe diskutimi me aktorët Kryerja e vlerësimeve të rregullta dhe zbatimi i mësimave të nxjerra Miratimi i Procedurave Standarde të Veprimit për ligjore për njësitë e KQZ-së



			Nxitja dhe konsolidimi i terminologjisë së njëjësuar zgjedhore mes aktorëve
--	--	--	---



2) DREJTORIA E KOMUNIKIMIT

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	
MASA STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Programe edukimi për periudhën e zgjedhjeve	Rritja e ndërgjegjësimit te votuesit për rëndësinë e procesit zgjedhor	Përgatitja e aktiviteteve	Diskutimi dhe rënia dakord për përparësitë dhe strategjinë e përgjithshme me drejtoritë e tjera të KQZ-së
			Përcaktimi i kriterëve të performancës (p.sh., afat i mjaftueshëm, numër dhe larmi eventesh, normat e pjesëmarrjes, grupet e synuara, hapësira gjeografike e veprimit, vizibilitetit në rrjete sociale dhe media, pjesëmarrja) dhe miratimi i procedurave të vlerësimit
		Zbatimi i programit	Miratimi dhe publikimi i kalendarit të aktiviteteve
			Rritja e publicitetit dhe komunikimit përmes aktiviteteve të vizibilitetit
Programe edukimi gjatë periudhës jozgjedhore	Rritja e ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve për rëndësinë e procesit zgjedhor	Dita Botërore e Zgjedhjeve	Takime, tryeza të rrumbullakëta dhe evente të tjera me grupet e synuara (p.sh., gra, të moshuar, votues për herë të parë, persona me aftësi të kufizuara)
			Kryerja e vlerësimit <i>ex-post</i> me një raport konkret me rekomandime. Vlerësimi i niveleve të komunikimit (p.sh., 70% e votuese / publiku i synuar me të cilin është komunikuar)
			Rritje e publicitetit dhe komunikimit
			Punë në tryeza të rrumbullakëta / me shoqërinë civile gjatë zgjedhjeve
			Konkurs për të rinjtë
			Botim i librit të kujtimeve nga proceset zgjedhore



		Përgatitja e aktiviteteve	Diskutim dhe rënie dakord rreth përparësive dhe strategjisë së përgjithshme me drejtoritë e tjera të KQZ-së
			Përcaktimi i kriterëve të performancës (p.sh., afat i mjaftueshëm, numër dhe larmi eventesh, nivelet e pjesëmarrjes, grupet e synuara, hapësira gjeografike e veprimt, vizibiliteti në rrjete sociale dhe media, pjesëmarrja) dhe miratimi i procedurave të vlerësimit
		Zbatimi i programit	Miratimi dhe publikimi i kalendarit të aktiviteteve
			Rritja e publicitetit dhe e komunikimit përmes aktiviteteve të vizibilitetit
			Takime, tryeza të rrumbullakëta dhe evente të tjera me grupet e synuara (p.sh., gra, të moshuar, votues për herë të parë, persona me aftësi të kufizuara)
			Kryerja e vlerësimit <i>ex-post</i> me një raport konkret me rekomandime. Vlerësimi i niveleve të komunikimit (p.sh., 70% e votuesve / publiku i synuar me të cilin është komunikuar)
Hartimi i materialeve të edukimit për periudhat zgjedhore dhe jozgjedhore	Përgatitja e produkteve edukuese që do të përdoren gjatë aktiviteteve të komunikimit	Hartimi	Kryerje e vlerësimit të nevojave
			Analizë krahasuese me zgjedhjet e mëparshme dhe vende të tjera
		Përcaktimet teknike dhe të përmbajtjes	Udhëzime për Manualin e materialeve edukuese
			Materiale në një gjuhë të kuptueshme për të gjithë votuesit
			Materiale në gjuhët e pakicave dhe në gjuhën e shenjave për personat me aftësi të kufizuara
	Vlerësim <i>ex-post</i> i ndikimit të materialeve edukuese. Vlerësim i përputhshmërisë me kriteret e përcaktuara më parë		



SHTYLLA STRATEGJIKE II (Sektori i Akreditimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar)		OBJEKTIVI STRATEGJIK 2	Ndërveprim intensiv dhe partneritet produktiv me të gjithë aktorët
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Fuqizimi i komunikimit sistematik me OJF të ndryshme (vendase dhe ndërkombëtare), si dhe me median	OJF-të dhe media janë të mirinformuara mbi KQZ-në dhe aktivitetet e tyre janë në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore	Rritje e aktiviteteve të komunikimit	Përmirësimi i faqes së internetit me rubrika të posaçme për akreditimet dhe median
			Tregues sasiore në kuptimin e numrit të postimeve apo numrit të vizitave ose përmbajtjes
			Përdorimi sistematik i mekanizmit të konsultimit me aktorët
			Aktivitete komunikimi të synuara, që do të organizohen mbi baza dypalëshe me palë të caktuara
Bashkëpunim strategjik dhe i zgjeruar me organizatat ndërkombëtare	Partnerët janë të mirinformuar rreth aktivitetit të KQZ-së, si dhe rreth hartimit të projekteve të mundshme për mbështetje të mëtejshme në të ardhmen	Përmirësohet procesi i akreditimit	Përcaktimi dhe publikimi paraprak i procedurave të akreditimit
			Tregues sasiore (p.sh., numri i vëzhguesve/mediave të akredituara/të refuzuara)
			Kryerje e sondazheve sistematike me aktorët, për të identifikuar hendeqet dhe fushat për përmirësim
			Shkëmbim sistematik i informacionit të përgjithshëm (p.sh., broshurë informative mujore)
Bashkëpunim strategjik dhe i zgjeruar me organizatat ndërkombëtare	Partnerët janë të mirinformuar rreth aktivitetit të KQZ-së, si dhe rreth hartimit të projekteve të mundshme për mbështetje të mëtejshme në të ardhmen	Përmirësohen kanalet e informimit dhe të komunikimit	Organizim i takimeve të rregullta në nivel të përgjithshëm dhe dypalësh me palët e synuara
			Përmirësohet zbatimi i projekteve të bashkëpunimit



			mbivendosjet dhe caktuar përparësitë. Nxjerrja dhe shpërndarja e raporteve të detajuara me shkrim.
			Udhëzime për menaxhimin e projekteve, për të cilat bihet dakord me aktorët
		Promovimi i KQZ-së në nivel rajonal dhe ndërkombëtar	Raport i vlerësimit të nevojave mbi llojet e evenimenteve/shkëmbimeve të praktikave të mira që duhen ndjekur dhe çështjet me përparësi për t'u trajtuar
			Përcaktimi i udhëzimeve për rekrutimin e personelit që do të ndjekë këto evenimente.



3) ZËDHËNËSI

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Krijimi i Qendrës së Medias
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Rritja e pranisë në të gjitha organet e medias sociale	Qasja e KQZ-së në të gjitha organet mediatike	Tërheqja e vëmendjes publike në të gjitha format dhe formatet në dispozicion të publikut të gjerë	Prani e rregullt në të gjitha stacionet televizive/radiofonike kombëtare
			Prani ditore në 70% të mediave sociale/portaleve
			Prani në organet e medias që iu drejtohen grupeve specifike të votuesve (p.sh., organet rajonale, revistat për personat me aftësi të kufizuara)
		Krijimi i infrastrukturës së transmetimit / dhënies së informacionit mbi KQZ-në për median / publikun në kohë reale	Ndërtimi i një platforme multimedia për të gjitha organet e mediave
			Rrahje idesh me aktorët mbi platformën, për ta përmirësuar më tej
			Ndërtimi i infrastrukturës për sallën e multimedias
Krijimi i formateve interesante tip për materiale/statistika/mesazhe	Punë me një specialist të punimeve grafike, për të prodhuar grafika interesante për informacione të ndryshme.		
	Faza e testimit të grafikave me njësitë e KQZ-së dhe me anketa		
	Kryerja e vlerësimit <i>ex-post</i> dhe zbatimi i mësimave të nxjerra		
Lufta kundër keqinformimit	Rritja e ndërgjegjësimit të medias rreth aktiviteteve dhe funksioneve të KQZ-së, me qëllim bllokimin e	Forcimi i koherencës së njohurive dhe mbikëqyrjes	Përhapja e njohurive për çështjet zgjedhore, përfshi terminologjinë, përmes fushatave të informimit, përfshi platformat digjitale
			Aktivitete ndërgjegjësuere me grupet e synuara



	keqinformimit gjatë fushatës / zgjedhjeve	Hartimi i kundërmasave për të luftuar keqinformimin	Aktivite ndërgjegjësuese (p.sh., seminare, tryeza të rrumbullakëta, fushata ndërgjegjësimi) mbi keqinformimin zgjedhor
			Kodi i Praktikave të Mira kundër Keqinformimit
			Vendosja e bashkëpunimit me nismat qytetare për çështjet zgjedhore



4) DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE SISTEMEVE INFORMATIKE (DADSIT)

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK	Sigurimi i infrastrukturës transparente për nxitjen dhe pjesëmarrjen e mërgatës në zgjedhje, përpunimin e rezultateve të besueshme zgjedhore dhe krijimin e një mjedisi elektronik për zhvillimin e zgjedhjeve
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Kuadër ligjor i përshtatur për nevojat e teknologjisë së informacionit	Ndërgjegjësimi mbi ndikimin e kuadrit ligjor në zbatimet e elementeve të teknologjisë së informacionit	Propozime për ndryshime të neneve të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore sa u takon paqartësive ose problemeve të hasura me teknologjinë e informacionit zgjedhjet e fundit.	Raport i nevojave të vlerësimit mbi hendeqet ligjore dhe aspektet e Teknologjive të Informacionit Hartimi, diskutimi dhe rënia dakord brenda KQZ-së mbi ndryshimet e propozuara Ndjekja në vijimësi e ndryshimeve dhe shtesave ligjore. Nxjerrja dhe shpërndarja e raporteve përkatëse tek aktorët.
		Hartimi i një strategjie për kontrollin e cilësisë	Përcaktimi i standardeve për pajisjet dhe shërbimet e KQZ-së Plan veprimi për cilësinë, me kontrole, afate, ndarje të detyrave dhe objektiva
		Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit	Pajisjet kompjuterike të personelit të KQZ-së Ngritja e rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik të administratës së KQZ-së Kontrolli i funksionalitetit të bazës së të dhënave të KQZ-së Trajnimi i personelit për kontrollin e cilësisë
Kontroll cilësie i pajisjeve dhe i shërbimeve	Përmirësimi i rezultateve të pajisjeve dhe shërbimeve të KQZ-së përmes kontroleve të funksionimit sipas standardeve të miratuara	Përmirësimi i punës së pajisjeve dhe garantimi i shërbimeve	Zbatimi i kontroleve të cilësisë sipas programit Nxjerrja e raporteve sistematike Kryerja e vlerësimit dhe zbatimi i mësimave të nxjerra
Zhvillimi i sistemeve specifike për	Rritja e besueshmërisë së publikut në proceset zgjedhore që lidhen me	Sigurimi i efikasitetit dhe shpejtësisë së operacioneve zgjedhore	Projektimi i sistemeve që synojnë automatizimin e proceseve të brendshme operationale të KQZ-së



administrimin e informacionit	identifikimin, regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë , votimin, numërimin elektronik		Implementimi i sistemeve të manaxhimit të informacionit në funksion të regjistrimit të zgjedhësve që banojnë jashtë vendit
			Staf i kualifikuar teknik për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve
		Sigurimi i shpejtësisë dhe besueshmërisë së transmetimit dhe shpalljes të rezultatit të zgjedhjeve	Rritja e aksesit për rezultatet në kohë reale në faqen zyrtare të KQZ-së
			Ngritja e infrastrukturës së modernizuar të për menaxhimin dhe transmetimin e rezultatit të zgjedhjeve
		Krijimi, përmirësimi i sistemeve për identifikimin dhe parandalimin e mashtrimit në zgjedhje	Krijimi i sistemeve të integruara të informacionit për procesin e numërimit dhe transmetimit të rezultateve
			Krijimi i një platforme të unifikuar për raportimin në kohë reale të pjesëmarrjes, denoncimeve, rezultateve
			Optimizimi i treguesve dhe moduleve që mundësojnë identifikimin e votimit të shumëfishtë



5) DREJTORIA E KONTROLLIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Digjitalizimi i të dhënave për procesin e monitorimit dhe auditimit.	Krijimi i një platforme, ku të dhënat e përfituara gjatë zhvillimit të procesit të monitorimit të subjekteve zgjedhore do të hidhen në kohë reale, së bashku me të dhënat e procesit të auditimit të partive politike.	Ideimi dhe projektimi i sistemit te platformës digjitale për financimin e partive politike	Diskutimi dhe përcaktimi i termave të referencës Ndërhyrja ne aktet nënligjore për mundësimin e realizimit të platformës Kontraktimi dhe testimi i platformës
		Implementimi dhe shtrirja e platformës	Vlerësimi i përshtypjeve të përdoruesve dhe harmonizimi i formateve tip E disponueshme për t'u vrojtuar në kohë reale Aksesueshmëri pa pengesa për aktorët, dhe reduktimi i përdorimit dhe administrimi i formateve të raportimit manuale në masën 90 % në 5 vitet e para.
		Shtrirja sa më e gjerë e zonave të monitorimit	Rritja e numrit të monitoruesve (deri në 120 në 2 vitet e para dhe në 200 monitorues brenda 5 viteve) Trajnimi periodik i të gjitha subjekteve, monitoruesve dhe audituesve për përdorimin e platformës.
		Rritja dhe garantimi i transparencës	Publikimi i të dhënave të hedhura në kohë reale



			Postimi i informacionit nga monitoruesit dhe audituesit brenda 24 orëve		
Ngritja e strukturës të trajnimit	Ngritja e një strukture trajnerësh mbi baza rajonale, të cilët do të shërbejnë për përgatitjen e monitoruesve dhe për t'i ndihmuar në kryerjen e funksioneve të tyre, si dhe për trajnimin e partive politike, aktorëve, shoqërisë civile dhe medias.	Rishikimi periodik i objektivave të trajnimit	Rritja e qëndrueshmërisë së objektivave pavarësisht ndryshimeve ligjore Sesione për shkëmbim idesh dhe pikëpamjesh për rishikimin dhe implementimin e ndryshimeve të mundshme.		
		Vlerësimi i vazhdueshëm i trajnimit	Hartimi i moduleve vjetore sipas objektivit të trajnimit Miratimi i procesit të certifikimit për të trajnuarit Vlerësimi dhe kontrolli i kryqëzuar (në fushat me monitorim të dyfishtë) pas procesit zgjedhor		
		Trajnimi i trajnerëve	Diskutimi dhe përcaktimi i kriterëve për rekrutimin e 30 trajnerëve Hartimi i dokumentacionit dhe moduleve të trajnimit Përcaktimi i vlerësimit për trajnimin e trajnerëve dhe marrja e masave të duhura përmirësuese		
		OBJEKTIVI STRATEGJIK 2		Hartëzimi i fushës së auditimit të brendshëm	
		Përcaktimi i shtyllave dhe i kontrolleve që përcaktojnë hartën e auditimit të brendshëm	Ofrimi i një burimi objektiv informacioni për drejtuesit e lartë lidhur me rrezikun, kontrollet, rregullat dhe praktikën rregullatore.	Strategjia e auditimit	Diskutim i brendshëm për përcaktimin e përparësive dhe afateve Hartimi i dokumentacionit me kriteret e auditimit, llojet e vlerësimeve dhe pasojat institucionale
				Zbatimi i planit të auditimit	Identifikimi i funksioneve të KQZ-së me rrezik të lartë, të mesëm dhe të ulët Realizimi i planit të auditimit dhe kryerja e vlerësimit <i>ex post</i>



Procesi i certifikimit të personelit	Personeli është trajnuar dhe certifikuar si duhet, në përputhje me nevojat e planit të auditimit	Baza për trajnimin	Zhvillimi i trajnimit të trajnerëve (d.m.th., rekrutimi i trajnerëve, dokumentacioni dhe vlerësimi)
			Hartimi i programit të trajnimit
		Zbatimi i trajnimit	Zhvillimi i trajnimit rregullisht
			Vlerësimi <i>ex-post</i>



6) DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCËS

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Optimizimi i menaxhimit financiar
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
Cikli i plotë i planifikimit dhe financimit të buxhetit	Identifikim i saktë i kërkesave buxhetore. Pavarësisht planifikimit të saktë të buxhetit, mund të ndodhë që jo të gjitha fondet e kërkuara të sigurohen. Koordinim i diversifikimit të financimeve të buxhetit	Rritje e bashkëpunimit midis drejtorive për një planifikim më të saktë dhe më të plotë gjatë fazave përgatitore të planit afatmesëm buxhetor, si dhe përpara nënshkrimit të kontratës, me qëllim që të mos identifikohen probleme gjatë zbatimit të kontratës	<p>Kërkesat për buxhetin janë në përputhje me kërkesat e të gjitha drejtorive së bashku.</p> <p>Kërkesat e drejtorive janë në përputhje me detyrimet ligjore të institucionit.</p> <p>Buxheti i vlefshëm është i mjaftueshëm për shlyerjen e të gjitha detyrimeve kontraktore.</p>
		Planifikimi i buxhetit në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave gjatë fazës së përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm	<p>Plani paraqitet në Sistemin Informativ Shqiptar të Menaxhimit Financiar, në përputhje me klasifikimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave.</p> <p>Plani është në përputhje me tavanet buxhetore.</p>
		Gjurmimi i aktivitetit të financimit në përputhje me buxhetet. Ngritja dhe menaxhimi i sistemit financiar për kontabilizimin e transaksioneve dhe raportimin financiar, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe udhëzimet që përkojnë me ato të Ministrisë së Financave	<p>Kryerja e pagesave në përputhje me planin.</p> <p>Regjistrim kontabël i të gjithë aktivitetit financiar.</p> <p>Rakordimi i të gjitha të dhënave të transaksioneve financiare me drejtorinë e buxhetit.</p> <p>Kryerja e koordinimit të diversifikimit të buxhetit, nëse ka mungesa buxhetore.</p>



<p>Përdorimi i teknologjisë për menaxhimin financiar dhe të aseteve</p>	<p>Përdorimi i teknologjisë së duhur, që siguron kontrollin e plotë dhe qasjen elektronike të buxhetit, kontratat dhe amortizimi i tyre, do të rritë elasticitetin e rishpërndarjes së fondeve brenda kuadrit ligjor</p>	<p>Krijimi i një platforme elektronike e përshtatur me nevojat financiare</p>	<p>Krijimi i modelit/sistemit financiar në përputhje me objektivat dhe kërkesat e institucionit.</p>
		<p>Zbatimi efikas i platformës elektronike</p>	<p>Zhvillimi dhe vënia në punë e softuerit informatik dhe testimet përkatëse.</p>
			<p>Hyrje në platformën e elektronike në çdo kohë.</p>
			<p>Nxjerrja e raporteve në përputhje me kërkesat ligjore dhe menaxhimin e brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Ndërgjegjësim mbi përditësimet ligjore që ndikojnë në Drejtorinë e Buxhetit & Financës</p>	<p>Shmangia e përkufizimeve joligjore në kontrata sa u takon termave financiare, duke shmangur ngatërresat gjatë procesit të përmbushjes së detyrimeve financiare</p>	<p>Përmirësimi i monitorimit të pajtueshmërisë ligjore</p>	<p>Kriteret e pagesës të jenë në përputhje me legjislacionin financiar.</p>
		<p>Shmangia e parashikimeve të pasakta dhe jo në kohë, që sjellin kërkesa të kufizuara për fonde buxhetore, të cilat janë të pamjaftueshme për të kryer të gjitha aktivitetet e nevojshme</p>	<p>Ofrimi i konsultimeve mbi kriteret financiare përpara nënshkrimit të kontratave.</p>
			<p>Dorëzimi i kërkesave të sakta për fonde buxhetore brenda afateve ligjore.</p>
			<p>Trajnim i vazhdueshëm i personelit për të përmirësuar punën.</p>

7) DREJTORIA E KOMISIONEVE DHE MATERIALEVE ZGJEDHORE

SHTYLLA STRATEGJIKE I		OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Përthithja dhe promovimi i trajnerëve të kualifikuar.
MASAT STRATEGJIKE	OBJEKTIVAT	AKTIVITETET STRATEGJIKE	TREGUESIT
